



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 862 Prot.

Tiranë, më datë 16.06.2023

VENDIM

Nr. 339, datë 16.06.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, Vendim Nr. 220, datë 07.04.2021 “Për Përcaktimin E Procedurave Për Hulumtimet Arkeologjike, Të Kushteve Të Posaçme Të Lëshimit Të Lejes, Dokumenteve Shoqëruese, Si Dhe Procedurave Për Shqyrtimin Ose Anulimin E Lejes Për Kryerjen E Hulumtimeve Arkeologjike” dhe “Rregullorja e arkeologut”, me Vendim Nr.2, datë 30.01.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.06.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes së projektit kërkimor-shkencor në vazhdim “Kërkime arkeologjike në zonën Vagalat/Dobra, fusha e Livadhjasë dhe lugina e mesme e Pavllës”, me bashkëdrejtues projekti Prof. Asoc. Dr. Belisa Muka dhe Dr. Milena Melfi, deri në momentin e:
 - Depozitimit të raportit të punës për vitin 2022;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

